

Parahistoria dhe historia antike e Kosovës

Edi Shukriu*

Përmbledhje

Territori i Kosovës ka ofruar material të konsiderueshëm arkeologjik, i cili, i kombinuar me të dhënat e burimeve të shkruara antike, mundëson konstatimin se banorët e parë të njohur të saj ishin ilirët (Herod. Historiae IV 49), rrjedhimisht dardanët, të krijuar nga gërshetimi i substratit neolitik dhe të adstratit eneolitik indoevropian. Formësimi i plotë i dardanëve u zhvillua gjatë epokës së hekurit (1200-400), kur dardanët krijuan territorin e tyre kompakt dhe i dhanë vendit emrin Dardania.

Kosova përbënte territorin qendror të Dardanisë, e cila shtrihej në hapësirën midis lumenjve Vardar, Dri, Moravë dhe Timok.¹ Zhvillimi paraurban dardan i shekujve VI-IV solli krijimin e shtetit dardan dhe bashkë me të dhe identitetin dardan, të ruajtur deri në periudhën bizantine.

Fjalët kyç: territori Kosovës, materiali arkeologjik, substrati neolitik, adstrati eneolitik, Dardanët, epoka e hekurit, lumenjtë Vardar, Drini, Morava, Timok, identiteti dardan, periudha romake, labyrinthi dardan, krishterimi i hershëm, migrimet indoevropiane, shteti dardan, nekropolet tumulare të Kosovës.

Parahistoria e Kosovës

Kushtet e volitshme natyrore dhe pozita gjeografike mundësoi zhvillimin e jetës në Kosovë që në parahistorinë e hershme. Ndonëse stacionet shpellore nuk janë hulumtuar ende, duket se shpellat e shumta të Kosovës kanë qenë stacione banimi gjatë epokës së paleolitit dhe të mezolitit, si dëshmon rasti i stacionit shpellor të Radavcit afër Pejës dhe i gjetjeve në rajonet në fqinjësi.

* Dr. Edi Shukriu, Profesor ordinar, Departamenti i Historisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, edishu2@yahoo.com

¹ Fanula Papazoglu, *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba* (Sarajevo, 1969), 143-161; Edi Shukriu, *Dardania paraurbane* (Pejë, 1996), 19 dhe literatura.

Klima atlantike neolitike, e nxehtë dhe me lagështi, mundësoi zhvillimin e bujqësisë (6000-3500) dhe lindjen e vendbanimeve sedentare pranë lumenjve apo në shpatet e kodrave të ulëta nga dielli që nga neoliti i hershëm (Runik/Ilirion, Zhitkoc, Glladnicë, Vlashnjë, Tupec, Reshtan). Në këtë kohë u zhvillua kultura starçeviane, e cila në disa pjesë bashkëjetoj me kulturën impreso adriatike dhe me elemente të kulturës thesalike, gjë që shpreh kontaktet e hershme rajonale. Gjatë neolitit të vonë u krijua kultura e Vinçës, rrjedhimisht faza e saj Vinça-Tordosh, e cila u zëvendësua me fazën eneolitike Vinça-Plloçnik. Rrjedhat gjatë epokës së eneolitit sollën ndryshime të mëdha, të cilat karakterizohen me dy elemente kyçe zhvillimore: (1) Përdorimi i bakrit dhe (2) Dyndja e fiseve indoevropiane. Në vazhdimësinë e jetës nga neoliti i vonë popullata vendëse nisi përdorimin e bakrit, duke shkelur kështu nga koha e gurit në kohën e metaleve (faza Vinça-Plloçnik). Shumësia e objekteve të kultit të kulturës së Starçevës dhe në veçanti të kulturës së Vinçës (figurinat antropomorfe e zoomorfe dhe altarët prej balte të pjekur) flasin për një botë të pasur shpirtërore, pos asaj materiale, ndërsa idolet e kulturës së Vinçës i arritën majat e shprehjes artistike në hapësirën e Kosovës (varianti Kosovë-Moravë Jugore).² Ndërhyrja e fiseve indoevropiane gjatë zhvillimit të kulturës Vinça-Plloçnik çrregulloi format e vjetra të jetës bujqësore, duke sjellë një frymë të re, të mbështetur kryesisht në ekonominë blegtorale (kultura Bubanj - Hum).

Pasiguria e kohës e krijuar me dyndjen e fiseve indoeuropiane shkaktoi zhvendosjen e banorëve vendës prej vendbanimeve rrafshinore në ato kodrinore të ulëta (Vlashnjë, Vallaç), ndërsa vetëm në disa vendbanime në rrafsh jeta vazhdoi më tej (Glladnicë, Tjerrtorë në Prishtinë, Fafos në Mitrovicë). Fiset indoeuropiane ngritën vendbanime mbi kodra të mbrojtura (Gadime e Epërme, Hisar, Veletin), duke sjellë dhe kulturë tjetër materiale dhe shpirtërore. Idolet e tyre prej bote të pjekur kishin trajtë pete të zgjatur dhe të lakuar, të ndryshme dhe nën nivelin

² Për zhvillimet në neolit shih: Milutin Garašanin, *Centralnobalkanska zona* (Sarajevo, 1979), 82, 185-193.

artistik të traditës neolitike dhe eneolitike vendëse. Në kuadër të proceseve të migrimeve ndërhyjnë edhe grupe gjysmë nomade nga hapësira e epërme danubiane (kultura e Badenit).³

Proceset integruese vazhduan gjatë epokës së bronzit (2100 - 1200), duke u mbështetur në ekonominë xehtare dhe tregtare, krahas asaj bujqësore dhe blegtorale. Numri i vogël i lokaliteteve të gërmuara të epokës së bronzit mundëson vetëm konstatime të përgjithshme për ekzistimin e vendbanimeve në kodra të ulëta (Vlashnjë, Teneshdoll) dhe të atyre të ndërtuara në rrafsh (Ljushtë, Qëndresan/Gillarevë, Glladnicë, Nasalë/Nosalë, Bernicë); të nekropoleve tumulare të mesit të epokës së bronzit (Rugovë, Ujz, Përçetë/Përçevë) dhe të nekropoleve të dysta me urna (Bernicë, Grashticë), të cilat i takojnë kalimit të epokës së bronzit në atë të hekurit. Gjetjet në Kosovë dëshmuuan lidhjet tregtare me kulturën e zhvilluar të Mikenës, gjatë epokës së bronzit të mesëm (shekujt XVI-XV) dhe kjo paralajmëron mundësinë e kontakteve dhe të ndikimeve më të hershme me qytetërimet mesdhetare.

Lidhshmëria midis dardanëve europianë me dardanët e Azisë së Vogël nuk është vënë në dyshim, por koha dhe drejtimi i degëzimit të dardanëve është ende temë trajtimi.⁴ Pa marrë parasysh faktet që do t'i ofrojnë hulumtimet e mëtejme, degëzimi i dardanëve duhet parë në suazat e valëve të migrimeve indoeuropiane (nga mijëvjeçari III p.K.) dhe në kohën e dyndjeve dorike (shekujt XIII-XII). Migrime të fiseve dardane kishte edhe në Itali në nismë të epokës së hekurit (shekulli XII p. K.). Në Apuli u vendosën daunët dhe darda, ndërsa galabrët zunë juglindjen e Italisë, duke ia dhënë vendit edhe emrin Kalabria.⁵

Epoka e hekurit është hulumtuar më shumë, ndërsa rezultatet që dolën nga hulumtimet dëshmojnë formësimin e plotë të

³ Për zhvillimet në eneolit shih: Nikola Tasic, *The Eneolithic Cultures of Central and West Balkans* (Belgrade, 1995).

⁴ Migrimet e dardanëve mbështeten edhe nga autorët antikë: Diod. *Bibliotheca historica* V 48; Solin II, 51 D 2. E. Thrämer mendon se një pjesë e dardanëve shkoi në Azi të Vogël bashkë me mezët dhe frikët: Eduard Thrämer, *Paulys Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft* - 2177: Dardanos (Stuttgart, 1901). Dardanët evropianë shihen edhe si degë e vonuar e dardanëve trojanë: John Wilkes, *The Illyrians* (Oxford, 1992), 145.

⁵ Fanula Papazoglu (Beograd, 1969), 103.

kulturës dardane në shekujt VIII-IV p.K., si dhe nismën e historisë antike dardane nga shekulli IV p.K.. Në kuadër të kësaj, zhvillimi i kulturës dardane shihet përmes tri fazave vijuese:

- I. Kultura paradardane ← IX p.K.
- II. Kultura dardane a VIII - fillimi VI p.K.
- b VI - mesi V p.K.
- c mesi V - mesi IV p.K.
- III. Kultura dardane urbane IV - I p.K.⁶

Vendbanimet e fazës protodardane gjenden në tarraca të lartësuar pranë lumenjve (Kllokot, Nasalë, Fafos II), ndërsa në fazën dardane u vendosën në kodra më të larta. Vendbanimet e fazës dardane janë shumështrësore, gjë që është shprehje e fuqizimit të dardanëve dhe të burimeve të qëndrueshme ekonomike (Gadime të Epërme, Hisar dhe Kasterc të Suharekës, Veletin, Bardh i Madh, Cernicë, Dubofc, Vlashnjë, Cermnjan, Zatriq, Pidiq, Teneshdoll, Artanë/ Novobërdë etj). Në epokën e hekurit u ngrehën ledhe rrethuese me dhe të përzier me gurë (Kulinë/Teneshdoll) apo vetëm ledhe gurësh (Veletin). Vendbanimet kodrinore njihen kryesisht me emrin *gradina* dhe *g(r)adisha* (indoeu.: gard, shqip: gardh).⁷ Në fazën paradardane varrimi është bërë edhe në varret e dysta me urna - kultura e Berrnicës (Berrnicë, Grashiticë), ndërsa gjatë fazës dardane në nekropole tumulare, duke përdorur të dy ritualet, atë të trupdjegies dhe të trupvënies (Romajë, Rogovë, Ujz, Shirokë, Dibçak, Porodime, Përçetë/Përçevë, Bajë e Pejës, Llashtishtë, Gurëz/Gërlicë, Biti, Moklikë). Nekropolet tumulare të Kosovës përkojnë me kompleksin kulturor të Gllasinacit dhe lidhen me tumat e Kukësit, Matit dhe Gllasinacit.⁸

Shekujt VI-IV p.K. karakterizohen me lindjen e aristokracisë fisnore dhe me zhvillim paraurban dardan. Në këtë periudhë paraqiten varret luksoze (Baja e Pejës), akropole të vendbanimeve

⁶ Edi Shukriu (Pejë, 1996), 23-36, 43-47.

⁷ Edi Shukriu, „Toponimi *g r a d i n ë* në suazat e zhvillimit të vendbanimeve kodrinore në Kosovë“, *Buletin i Fakultetit Filozofik* (Prishtinë 1994), f.127-133.

⁸ Bep Jubani, *Të dhëna për kulturën tumulare në Shqipërinë verilindore* (Prishtinë 1978), 152; Idem, *Tumat ilire të Kënetës* (Tiranë 1983), 111; Borivoje Čović, *Pogrebni običaji preistorijskih stanovnika glasinackog područja* (Sarajevo, 1963), 52.

kodrinore, punime të organizuara masive (krijimi i tarracës II në Gradinën e Gadimes së Epërme) apo zejtaria poçare me trajta autoktone dhe të huazuara helene (skifosë, kilikë, kantarosë, hidria, lekanë, olpa, kraterë, pitosë, amfora).⁹ Zejtarët dardanë prodhuan stoli, armë dhe vegla pune, traditën e së cilës shekuj më vonë e vë në pah Plini, duke shkruar: *Madje edhe burrat mbajnë në llërën e sipërme të dorës (rrathë ari), të cilat vinin nga Dardania dhe për këtë quheshin dardane* (Plin. Naturalis Historiae XXIII 3, 12). Kësaj tradite i përkojnë stolitë e argjendta (byzylykë dhe unaza nga Baja e Pejës); armët e njohura si shpata harkore - mahaira, prejardhja e së cilës gjendet në hapësirën iliro-dardane;¹⁰ përkrenaret ilire të prodhuara në Dardani (përkrenaret nga Baja e Pejës, Korisha dhe Deja), si dhe sëpatat dytehëshe - labrys nga Romaja (varret 1, 5, 9, 17) dhe Shiroka.

Kontaktet dardane me botën e zhvilluar mesdhetare qenë të hershme (importet mikenase të epokës së bronzit në Qëndresan/Gllarevë), por gjatë epokës së hekurit këto u intensifikuan. Nga shekulli VII p.K. u krijuan lidhjet intensive tregtare me botën helene edhe përmes Halkidikut (amforat e Hiosit, enë me mbishkrim arkaik grek, monedha të Tasosit), importet e shekullit VI p.K., si janë Menada e Prizrenit, ojnohea dhe kupat me figura të zeza nga Baja e Pejës, qeramika e stilit Wave-Line apo mbishkrimi me alfabetin arkaik grek nga Gadimja.¹¹ Shekujve V- IV p.K. u takon qeramika e tipit Saint Valentin nga Gadimja e Cernica,¹² dhe mbishkrimi grek ΑΙΤΟΥΓΑΝ në enën nga Kulina.¹³ Përhapjen e shkrimit grek në hapësirën e Kosovës e dëshmojnë edhe prezenca e shkronjës "E" në pitosin nga Cernica, e shkronjës „psi" nga Bardhi i Madh, e shkronjës "M" nga Gadimja apo e shkronjës "B" në pitosin nga Hisari i Suharekës/Therandës.¹⁴

Importet e zbuluara në Kosovë dëshmojnë se Dardanët në këtë periudhë dhe më pas nuk ishin të panjohur për botën helene. Andaj, edhe instrumentalistja dardane, e cila paraqitet

⁹ Edi Shukriu (Pejë, 1996), 87-97.

¹⁰ Maja Parović, *Grčka mahaira i problem grčkih mačeva* (Sarajevo, 1982), 18, 42.

¹¹ Edi Shukriu (Pejë, 1996), 57, T. XVII, 1.

¹² Ibidem, 56-58, 87-95, T.XXVI 1-4, T. XXXII 1.

¹³ Haxhi Mehmetaj, *Kulina-Teneshdol* (Ljubljana, 1990), Arheološki pregled, 1988, 96-99.

¹⁴ Edi Shukriu (Pejë, 1996), T. XXX 6, T. XIV 7, T. XLIX 8.

në komedinë e Aristofanit *Grerëzat*,¹⁵ mund t'u përket po aq dardanëve të Europës, sa atyre të Azisë. Po ashtu ka gjasa që dardanët e Europës të kenë qenë temë trajtimi në komeditë *Dardanos* të shkrimtarit grek Menandrit dhe *Dardanus* të shkrimtarit romak Cecil Statit.¹⁶ Dardanë europianë mund të jenë edhe individët, emrat e të cilëve janë shënuar në monumentet epigrafike të Atikës në Greqi, si Mate(.)a Oadayou Thygater Dardanis (shek. II p.K.), Thespis Niketou Dardaneys (shek. II-I p.K.), Dardanos Erakleonos Dardaneys (shek. I p.K.), Dorotheos Afrodisiou Dardaneys (shek. I p.K.), Biote Dardanissa dhe Epafrodita Dardanis (shek. I).¹⁷

Besimi i fazës paraurbane dardane karakterizohet me dominimin e kultit të diellit, të përhapur te ilirët e veriut, dhe kultit të gjarprit, dominues tek ilirët e jugut.¹⁸ Besimi heliolatrik zinte vend të veçantë (artefaktet solare në tumat e Shirokës, shpezët në tumën e Llashticës, sëpatat dytehëshe nga tuma e Romajës), si dhe te dardanët e periudhës romake (monumenti i Hyjneshës Dardane nga Smira),¹⁹ përfytyrimi i së cilës është shprehur në monumentet e periudhës romake nga Romula Malva (Rumuni)²⁰ dhe në shtatoren nga Mediana.²¹ Shufrat e gjata prej hekuri, të cilat u zbuluan në Tumën e Luftëtarëve të Romajës (shekujt VI-V) dëshmojnë se dardanët kishin krijuar konceptin mbi jetën e tejbotshme,²² të manifestuar më vonë në labyrinthin rrethor të qarkut të mbyllur nga monumenti votiv i Smirës.

¹⁵ David Barrett, *Aristophanes, The Wasps* (London 1964).

¹⁶ Edi Shukriu, *Dardanët në veprat e Aristofanit, Menandrit e Cecil Statit* (Prishtinë, 2001), 87-95.

¹⁷ F. Papazoglu i sheh si dardanë të Azisë së Vogël: Fanula Papazoglu, (Beograd, 1969), 170, f.n. 285. Shih: IG II/III(2), 8417-8476.

¹⁸ Aleksandar Stipčević, *Kulturni simboli kod ilira* (Sarajevo, 1981), 56.

¹⁹ Edi Shukriu, *Perëndesha Dardane - Ikonografia e monumenteve, simbolet dhe funksionet* (Prishtinë, 2004b).

²⁰ Dumitru Tudor - Cristian Vladescu, *Dardanii la Romula-Malva* (Alba Julia, 1972), 183-190; Dumitru Tudor, *Oltenia romana* (Bukarest, 1978), 369, fot. 102, 103.

²¹ Shtatorja u pa me hezitime nga studiues të ndryshëm si Demetra apo Kibela, ndërsa më vonë si personifikim i Dardanisë: Aleksadnar Jovanović, *Prilog proučavanju skulptura sa Medijane* (Niš, 1980), 51 dhe si Hyjneshë Dardane: Edi Shukriu (Prishtinë, 2004b), 11-13.

²² Shufrat si njet pagese janë evidencuar edhe në varrezat e zbuluara në Slloveni, në Gjermani, në Francë dhe në varret etruske të shekujve VIII-VII: Joseph Dechelette, *Manuel d'archeologie prehistorique, celtique et gallo-romaine* (Paris, 1927), 287-292.

Historia antike e Kosovës

Historia antike e Kosovës nis me krijimin e shtetit të Dardanisë, i cili u zhvillua gjatë shekujve IV-I. Nisma e historisë antike dardane është rezultat i faktorëve të shumtë, por rol kyç kishin zhvillimi paraprak protourban dardan (shekujt VI-IV); zhvillimi i zejtarisë dhe krijimi i qendrave urbane, që solli shthurrjen e rendit fisnor, dhe diferencimi shoqëror, që përfshiu edhe skllevërit (dulët) dhe robërit e luftës.

Shteti dardan kishte territor kompakt dhe të përkufizuar, popullsi të njohur me emrin dardanë, ushtri të organizuar, institucionin e mbretit (Longari, Bato, Monuni); fronin trashëgues (Bato trashëgoi të atin Longarin),²³ si dhe veprimtari diplomatike dhe martesë dinastike. Andaj, nuk është e rastësishme që shkrimtarët antikë vetëm këta banorë të Ballkanit qendror i quajtën me termin përcaktues gjeografik dhe politik: dardanë dhe Dardania (Strab. VII c. 313, c. 316).

Gjatë zhvillimit të tij shteti dardan u zgjerua në veri dhe në veriperëndim, duke përvetësuar territoret e tribalëve dhe të autariatëve (territori rreth Novi Pazarit të sotëm)²⁴ dhe në drejtim të jugperëndimit, duke marrë kontrollin mbi territorin e taulantëve²⁵ dhe hapësirën deri te Gostivari i sotëm.²⁶ Kufijtë perëndimorë duket se përfshinë edhe rajonin e Kukësit të sotëm (territori i pirustëve). Ndërkohë, përfshirja e gati gjithë Peonisë²⁷ i bëri dardanët fqinjë të drejtpërdrejt të Maqedonisë, që kishte si rrjedhim konfliktet e vazhdueshme midis tyre dhe dhe paraqitjen e dardanëve. Andaj, nuk është rastësi që dëshmitë e shkruara mbi historinë politike të Dardanisë u paraqitën nga viti 345 p.K.,²⁸ kur

²³ Fanula Papazoglu, *Ilirska i dardanska Kraljevina* (Beograd, 1988), 162, f.n. 69.

²⁴ Kësaj i ndihmoi dobësimi i autariatëve dhe dyndja e një pjese të madhe të autoriatëve në vitin 310 p.K. për shkak të invadimit të bretkosave që binin nga qielli: Diodor XX 19, 1; Athen. Historia 21.

²⁵ John Wilkes, *The Illyrians* (Oxford, 1992), 146.

²⁶ Alfred Moscy, *Gesellschaft und Romanisation der romischen Provinz Moesia Superior*, (Budapest, 1970), 9-17. Mohimi i përfshirjes së këtij territori në Dardani për shkak se aty janë gjetur shumë mbishkrime në gjuhën greke nuk qëndron, sepse edhe në Shkup janë gjetur të tilla dhe Shkupit nuk i mohohet përfshirja në kuadër të Dardanisë.

²⁷ Pjesa perëndimore e IRJ të Maqedonisë.

²⁸ Mbishkrimi nga Oleveni: Pierre Cabane, *Illyriens des Bardylis à Genthios IVe-IIe siècles avants J.C.*, (Paris, 1988), 50, f.n. 80, 81.

Dardania hyri në sferën e interesit të Maqedonisë dhe të interesimit të shkrimtarëve antik për të. Luftimet e vazhdueshme dhe përpjekjet e mbretërve të Maqedonisë për t'i mbrojtur kufijtë verior nga dardanët dhe aleatët e tyre i potencon edhe studiuesi F.W. Walbank, i cili shkruan: *Për çdo mbret maqedon çështja e parë dhe më qenësore ishte ajo e kufijve verior.*²⁹

Në fillim të shekullit III p.K. forca e shtetit dardan ishte aq e madhe sa që mbreti dardan i ofroi mbretit të Maqedonisë Ptolome Keraunit një ndihmë prej 20.000 ushtarësh për luftë kundër invazionit gal (Justin. *Historiarum Philippicarum* XXIV 4 9-11. Viti 279 p.K.). Ndonëse numri i ushtarëve të ofruar mund të jetë i ekzagjeruar, kjo nuk e zvogëlon peshën dhe fuqinë e Dardanisë. Shpërputhja e interesave dhe luftërat kundër Maqedonisë bënë që dardanët të lidhin aleancë me romakët (200 p.K.) dhe të bëhen pjesëmarrës të koalicionit antimaqedon, duke marrë pjesë edhe në Luftën e Dytë romake-maqedonase (Liv. XXXI 28, 1). Pas vitit 197 p.K., dardanët e pakënaqur me aleatët romakë, i vazhduan sulmet kundër Maqedonisë, ndërsa etholëve u dhanë mercenarë në luftë kundër romakëve (Liv. XXXVII 48, 4). Përkundër nismës së armiqësisë së re, tani me romakët, dardanët dërguan një delegacion në Senatën romak në vitin 177 p.K., ku akuzuan Perseun, djalin e Filipit V, për planet që i bënte Maqedonia për t'i shfarosur dardanët (Polyb. *Historiae* XXV 6, 2).

Dardanët dolën plotësisht nga koalicioni antimaqedon pas pushtimit romak të Maqedonisë dhe krijimit të Provincës së Maqedonisë (168 p.K.), të pakënaqur nga aleanca me romakët nga të cilët përfituan vetëm të drejtën për të bërë tregti me kripë (Liv., XLV 29 13: *salis commercium*). Nga kjo kohë dardanët zhvilluan politikë të pavarur dhe forcuan lidhjet me aleatët (Appianus, *Illyrica*, 187). Në luftimet kundër romakëve, fqinjëve të rinj, dardanët u bashkuan me ilirët e tjerë, madje u realizua dhe martesë dinastike e Etutës, vajzës së mbretit dardan, me mbretin e shtetit ilir Gencin (Polyb. XXIX 13, 12; Liv. XIV 30, 4). Megjithëkëtë, bashkëveprimi kryesor i dardanëve ishte me medët, përmes aksioneve të përbashkëta kundër provincës romake të Maqedonisë dhe të ndalimit të

²⁹ Frank W. Walbank, *Philip V of Macedon* (Cambridge, 1940), 270.

depërtimit të legjioneve romake në drejtim të Dardanisë dhe më në veri.

Dardanët i rezistuan sulmeve romake të viteve 97 p.K., 85 p.K. dhe 77/6 p.K, ndërsa gjatë viteve në vitin 75-73 p.K. u zhvilluan luftimet e tmerrshme, të njohura në historinë antike me emrin *Bellum dardanica* (Front. Strategematon IV 1, 43). Mbi rëndësinë e fitores mbi shtetin dardan flet fakti se fituesit Kurionit iu organizua hyrja triumfale në Romë, në vitin 72 p.K. (Rufus Festus, *Breviarum gestarum populi romani*, III, VIII). Ndëshkimi romak ndaj dardanëve nuk e ndali rezistencën dardane ndaj pushtuesve romak, ndonëse dardanët u gjetën në një pozitë juridike gjysmë të varur: *foedus iniquum* (D. Cass. XXXVIII 10, 1-2). Më se një shekull dardanët iu kundërvunë dominimit të plotë romak, duke shkatërruar ndërkohë edhe ushtrinë e prokonzulit Hibrida (Cai Antonius Hibrida). Në vitin 48 p.K. kalorësit dardanë morën pjesë në luftën e triumvirëve, duke marrë anën e Pompeut kundër Cezarit (Caesar, *Bellum civile* III 4, 6), në vitin 38 p.K. triumviri Mark Antoni e dërgoi ushtrinë që të luftojë përsëri në Dardani, ndërsa në vitin 29 p.K., pasi që Mark Kraso luftoi kundër dakëve dhe bastarnëve, u nis edhe kundër dardanëve. Tek pas luftës së Mezisë (28 p.K.) romakët e lidhën fatin e Dardanisë me provincën romake të Mezisë (Moesia) dhe, më pas, të Mezisë së Epërme (Moesia Superior).

Ushtria dardane ishte e organizuar në fallanga (njësi), sipas modelit helen. Fallanga kishte 8.000 ushtarë (Veget. *Epit. R. mil.* II 1, 2) dhe në të përfshiheshin *principes*, *hastate* dhe *triarki*.³⁰ Këmbësoria e armatosur me armë të rënda përbënte pjesën më të madhe të ushtrisë (Liv. XXXI 43 3), ndërsa në të merrte pjesë edhe fshatarësia. Komandën mbi ushtrinë e kishte mbreti, i cili në të shumtën e rasteve e udhëhiqte betejën (Liv. XXV 28, 2). Në përbërje të ushtrisë kishte edhe ushtarë profesionistë, me paga apo mercenarë. Kalorësit mercenarë dardan u morën edhe nga etolët, në luftën kundër romakëve të vitit 190 p.K., ndërsa këta morën pjesë dhe në luftërat qytetare romake, si ajo e triumvirëve të vitit 48 p.K. (Caes. *Bellum civile* III 4, 6) apo në betejën e Farsalës.

³⁰ Mbi ndikimet e traditës helenistike në ushtrinë dardane: John Wilkes, *op.cit.*, 150.

Bazën e ekonomisë dardane e përbënin prodhimet bujqësore, blegtorale, artizanale, përpunimi i metaleve të çmuara dhe tregtia. Prodhimet dardane u bënë të njohura në botën antike, si armët (shpatat e tipit mahaira); rrathët prej ari (Plin. *Naturalis Historiae* XXXIII 3 12), djathi i Sharrit apo djathi dardan (*caseus dardanicus*), bashkë me dhjamin e dërrit, hekurin dhe plumbin (*Descriptio totius mundi et gentium* A 51). I njohur ishte dhe qeni i Sharrit, si dhe është evidentuar edhe ekzistimi i një numri të madh qesh (M. T. Varronis, *De re rustica* II 1). Po ashtu, u kultivua hardhia e rrushit dhe zuri vend prodhimtaria e verës, që është e njohur te të dy popujt më të hershëm të Ballkanit, ilirët dhe grekët.³¹ Duket se prodhimet e zejtarëve drugdhendës ishin po aq të preferuara, përderisa druri ishte materiali më i preferuar për trajtësim plastik dhe artistik, si edhe tek ilirët e tjerë.³² Kjo dëshmohet nga analiza e monumenteve gurore ilire, të krijuara para dhe pas pushtimeve romake, pasi që veprimi teknik mbi monumentet gurore është përcjellë nga teknika e përpunimit të drurit.³³ Teknikë e tillë është përcjellë edhe në monumentin mortor nga Dardana/Kamenica, i vetmi monument guror i kësaj periudhe.³⁴

Qarkullimi i monedhave në Dardani është evidentuar nga shekulli V p.K.,³⁵ për t'u intensivuar nga shekullin IV p.K.. Qyteti Damastion, i vendosur në Dardani apo në afërsi të saj, farkoi monedha deri në vitin 320 p.K.³⁶ Nga shekulli III p.K. u gjetën në qarkullim monedha nga territore të ndryshme: staterë të Tebës (400-390), të Histrisë dhe të Apollonisë së Thrakisë (350 p. K.), të Lekës së Madh, të Filipit III, të Athinës (177-176), të Dyrrahut dhe të Apolonisë së Ilirisë (III-I), të Pellagonisë,

³¹ Marin Zaninović, *Iliri i vinova loza* (Sarajevo, 1976), 261.

³² Dimitri Sergejevski, *Iz problematike ilirske umjetnosti* (Sarajevo 1965), 120-121; Aleksandar Stipčević, *Iliri* (Zagreb, 1974), 217.

³³ Branko Gabričević, *Solarni koncept duše u religiji ilira* (Split, 1987), Studije i članci o religijama i kultovima antičkog svijeta, 24; Duje Rendić-Miočević, *Iliri i antički svijet* (Split, 1989), 437.

³⁴ Duket se monumenti mund të datohet edhe më heret se shekulli IV p.K.

³⁵ Edi Shukriu (Pejë, 1996), 99-100; Gojko Kraljević, *Antički novci nabaoljeni u Janjevu za Zbirku Zemaljskog muzeja u Sarajevu*, (Priština, 1984), Glasnik Muzeja Kosova XIII-XIV, 85.

³⁶ John M.F. May, *The coinage of Damastion and the lesser coinages of the Illyro-Paenonian region* (London, 1939), 120.

tetradrahma të argjendta të Peonisë, ndërsa nga shekulli II p.K. hynë në qarkullim denarët e republikës së Romës.

Shoqëria e diferencuar dardane e shekujve IV-I përbëhej nga aristokracia skllavopronare në krye me mbretin, në të cilën përfshiheshin edhe priftërinjtë dhe shtresa e lartë ushtarake; shtresa e xehetarëve, zejtarëve dhe tregtarëve; fshatarësia e lirë dhe skllavërit, të përbërë nga dullët (*douloi*: Athenaeus, Deipnosophiste VI 103, 277d) dhe robërit e luftës (Iust. XXIX 4, 5).

Dardania pararomake njihte dhe qytetet, si dëshmon shkrimtari romak Tit Livi, i cili i shënon me emrin e përgjithshëm *urbs* (Liv. Ab urbe condita XXV 25 3; XL 4 7-10; XLI 19 7), ndërsa në një rast përmend qytetin që ka ekzistuar në vitin 176 p.K. (Liv. XLI 19 7-10). Këto të dhëna sjellin në përfundim se në Dardani: 1) u ngritën qytete para pushtimeve romake, 2) kishte qytete në shekullin II p.K. dhe 3) qytetet janë ngritur më herët se shekulli II p.K. Përkundër të dhënave të shkruara, të dhënat arkeologjike ende mungojnë mbi qendrat urbane dhe vendbanimet në përgjithësi, mbi vendvarrimet, si dhe mbi kulturën materiale. Duket se qendrat urbane të shekujve IV-I janë zhvilluar në rrafsh, jo larg qendrave të mëhershme kodrinore paraurbane, në të cilat jeta është shuar gradualisht nga mesi i shekullit IV p.K.,³⁷ si ngjau me vendbanimet e tjera dardane të pellgut të Shkupit (Kalaja e Shkupit, Nerezi, Varvara, Studençan).³⁸ Vendosja e vendbanimeve në hapësira më të dysta dhe si të tilla më të vështira për t'u zbuluar, duket të jetë rezultat i fuqizimit politik dardan dhe i ndjenjës së sigurisë në territorin qendror dardan, si dhe i marrëdhënieve të reja ekonomike dhe i zhvillimit të brendshëm të shoqërisë dardane.

Mungesa e zbulimeve arkeologjike në Kosovë të periudhës së ekzistimit të shtetit dardan ka si rrjedhim gjetjen e një numri tejet të vogël të artefakteve të kësaj periudhe, përderisa disa janë zbuluar në rrethin e Shkupit e në Maqedoni në përgjithësi, si dhe në territoret në veri dhe verilindje të Kosovës (Baja e Kurshumlisë, Kërshevisa te Vranja). Kësaj periudhe i përkasin vetëm varret e shekujve III-II, të zbuluara në tumën e Romajës

³⁷ Edi Shukriu (Pejë, 1996), 150.

³⁸ Ivan Mikulčić, *Skopje so okolnite tvrdini* (Skopje 1982), 32.

(përmbanin importe helene: enë metalike dhe enë të tipit të Megarës); varre të zbuluara rastësisht te Artana/Novobërda, të cilat përmbanin qeramikë helenistike, enë metalike dhe terakota; Cjapi i bronzit nga Prizreni (Muzeu i Vranjës); Figura e Lajmëtarit nga Pirana e Prizrenit; lotorja nga Zotaj dhe disa fibula të shekujve II-I nga Vërmica e Prizrenit.

Bota shpirtërore dhe religjioze dardane u zhvillua krahas zhvillimit urban dhe atij shtetëror, duke sinkretizuar kultet e mëhershme dhe duke u dhënë perëndive trajta antropomorfe. Kështu, sipas modelit të mbretërisë, u krijua mbretëria qiellore dardane, ku duket vend më të rëndësishëm kishin Hyjnesha Dardane dhe Andini. Ritualet religjioze krijuan bazë edhe për zhvillimin e artit skeniko-muzikor dhe vizuel, që dëshmohet nga vallëzimi mortar apo vallëzimi hyjnor të paraqitur në monumentin mortar të Dardanës/Kamenicës. Labyrinthi rrethor në monumentin e Hyjneshës Dardane, si dhe labyrinthet e tjera që paraqesin një arkitekturë të hapësirës dhe të kohës së përfytyruar,³⁹ paralajmëron dijet kosmogonike dhe kosmologjike dardane.⁴⁰

Kosova e periudhës romake

Pushtimet romake të Dardanisë sollën ndryshime të mëdha administrativo-juridike, si dhe në jetën e banorëve në përgjithësi. Në vitin 44 Dardania u vendos në provincën e Mezisë, ndërsa në vitin 86, pas ndarjes së Mezisë, Dardania u bë pjesë e provincës Mezia e Epërme (Moesia Superior).⁴¹ Vendosja e Dardanisë në korniza administrativo-juridike me territoret në veri e futën këtë në një konglomeracion artificial, duke ia shkëputur në masë të madhe edhe lidhjet tradicionale me jugun dhe me vendet e Mesdheut.

³⁹ Penelope R. Doob, *The idea of the Labyrinth from Classical Antiquity through the Middle Ages* (Ithaca-London, 1990), 1.

⁴⁰ Edi Shukriu (Prishtinë, 2004b). Në këtë kuadër duhet parë edhe monumentit relievor mortar nga Dardana/Kamenica: Idem (Prishtinë, 2004a), 23, fot. 10.

⁴¹ Naser Ferri, *Monumentet ushtarake të periudhës romake në Mezi të Epërme* (Pejë, 2001), 55; Ronald Syme, *Legates of Moesia*, (Bucarest, 1968), Dacia 12/1968, 331.

Dardanët nuk u pajtuan me okupimin romak për një kohë të gjatë dhe as me vendosjen e tyre në kufijtë e imponuar, gjë që u shpreh edhe me veprimet e pareshtura të kryengritësve dardanë (*latrones dardanicii*). Si rrjedhim dhe pas reformave të perandorit Dioklecian (279) u krijua Provinca e Dardanisë, si pjesë përbërëse e prefekturës së Ilirikut (*praefectura praetorio per Illyricum*), përkatësisht e dioqezës së Maqedonisë, bashkë me atë të provincën Prevalit, Epirit të Vjetër dhe Epirit të Ri. Kufijtë e provincës ishin të njëjta me ato të shtetit të dikurshëm dardan, pos pjesës verilindore, e cila iu nda provincës Dacia Ripensis, të formuar më parë.⁴²

Perandorisë romake dhe pastaj asaj bizantine iu desh mund i madh që ta mbajë pushtetin në Dardani. Kjo u arrit përmes vendosjes së trupave të mëdha ushtarake romake në hapësirën dardane, fillimisht të Legjionit IV të Skitëve (*Legio IV Scythica*, deri në vitin 57) dhe Legjionit V të Maqedonëve (*Legio V Macedonica*, deri në vitin 62). Në kohën e dinastisë së Flavëve u vendos Legjioni VII i Klaudëve (*Legio VII Claudia*) dhe, më vonë, Legjioni IV i Flavëve (*Legio IV Flavia*). Në shekujt I-II u krijua *ala Vespaziana Dardanorum*, me 500 kalorës dardanë, që mbronte distriktet xehetare të rajonit xehetar Artanë/Novobërdë - Kopaonik. Në vitin 169 nga latronët dardanë u krijuan dy kohorta me nga 600 ushtarë: Kohorta Dardane I (*Cohors I Aurelia Dardanorum*) dhe Kohorta Dardane II (*Cohors II Aurelia Dardanorum*). Aureliani i vendosi kohortat në kufi, në Timacus Maius (Knazhevc) e Timacus Minus (Ravna), duke e zbehur kështu rrezikun nga latronët.

Dardanët morën pjesë edhe në njësitet etnike dhe territoriale të ushtrisë romake, të cilat shërbenin jashtë Dardanisë. Të tilla ishin *Ala Vespaziana Dardanorum*, *Ala Moesica*, *Felix Torquata*, *Ala I Illyricum* dhe *Legio I Illyricum*.⁴³ Nga viti 373 u formuan formacionet *pseudocomitatens*, ndërsa deri në shekullin VI sigurinë në Dardani e mbanin *pseudocomitatenses Scupiensis*, *Ulpianenses et Merenses*, të cilët ishin nën komandën e magistrut ushtarak për Ilirikun (*magister militum per Illyricum*).

⁴² Fanula Papazoglu (Beograd, 1969), 151.

⁴³ Naser Ferri (Pejë, 2001), 323.

Rrjeti i dendur i rrugëve të ndërtuara në periudhën romake e mundësoi lëvizjen e shpejtë të legjioneve, administrimin më të lehtë të sundimtarëve romak, shfrytëzimin e pasurive të Dardanisë dhe transportin e shpejtë të metaleve të çmuara. Ndërtimi i rrugëve nisi në kohën e perandorit August dhe këto u riparuan kohë pas kohe. Aktiviteti riparues në Kosovë dëshmohet nga miljtëreguesit e Antonin Piut dhe të Aurelianit, të gjetur në afërsi të Kaçanikut, te Hani i Elezit dhe te Lupçi i Poshtëm.⁴⁴

Magjistranja Lissus – Naissus ishte rruga më e rëndësishme që e përshkonte Kosovën. Magjistranja kryqëzohej te stacioni Viciano me magjistralen që shpinte në lindje, në drejtim të Shkupit (Scupi) dhe magjistrales Viminacium-Scupi-Thessalonike, dhe në përfundim në drejtim të provincës së Dalmacisë dhe bregdetit Adriatik. Në Kosovë kishte dhe rrugë vicinale, të cilat lidhnin qendrat më të vogla me dy magjistratet. Pjesë të trasesë rrugore Viciano–Scupi janë gjetur te Hani i Elezit, bashkë me dy miljtëregues të kohës së Hadrianit dhe Antonin Piut, ndërsa në Vendenis (Gllamnik) është zbuluar struktura e rrugës prej gurësh të mëdhenj të thyer, që ka substruksion shtresë të trashë rëre, të vendosur mbi dhe të shtypur (4.60 m).⁴⁵

Romakët gjetën ekonomi të formësuar antike në Dardani, e cila kishte mbështetje të qëndrueshme në bujqësi dhe blegtori, në xehetari dhe metalurgji, në zejë të ndryshme dhe në tregti. Romakët u koncentruan veçanërisht në shfrytëzimin e xeheve, si edhe në provincat e tjera,⁴⁶ dhe në ndërtimin e rrugëve. Si rrjedhojë vazhdoi shfrytëzimi i xeheroreve në dy komplekset më të mëdha xehetare, në kompleksin e Ibrit (Trepçë-Kopaonik-Rogoznë) dhe në kompleksin Kosovë - Moravë Jugore (Ajvali-Janjevë-Artanë).

Sundimi romak çrregulloi marrëdhëniet e mëhershme të pronësisë me shpalljen e pronës bujqësore si pronë publike: *ager publicus* dhe si pronë provinciale: *ager provincialis*.⁴⁷ Shndërrimi i

⁴⁴ Emil Čerškov, *Rimljani na Kosovu i Metohiji* (Beograd 1969), 9.

⁴⁵ Idem, *Oko problema komunikacija i položaja naselja na Kosovu i Metohiji* (Priština, 1957), 68; Slobodan Fidanovski, *Poljanica, Glaonik, Podujevo – rimska nekropola* (Ljubljana, 1985), 100, 102.

⁴⁶ Michael Rostovtzeff, *The Social and Economic History of the Roman Empire* (Oxford 1957), 242-243.

⁴⁷ Ibidem, 52.

vendbanimeve në trajta të pushtetit romak pati pasojë përvetësimin e pjesës më të mirë të tokës nga romakët dhe nga ata që u shërbenin romakëve. Ndonëse me vonesë, në Kosovë u krijuan prona të mëdha, siç ishin ato të familjes patrice romake Furri, të files Papinia apo të pjesëtarëve të tribës romake Quirinia, të njohur nga monumenti përkushtuar Jupiterit nga Smira.

Blegtoria, si pjesë më konservative e ekonomisë, vazhdoi të jetë degë e rëndësishme, ndërsa tregtia fitoi kualitet të ri dhe u bë bartësi kryesor i sjelljes së kulturës dhe mënyrës së jetës romake. Nevojave të ekonomisë u shërbenin stacionet doganore, në veçanti *stationes vectigalis Illyrici*, të cilat ishin nën kontrollin e perandorit. Stacione të tilla në Kosovë kishte në Ulpianë, në Gushtericë të Poshtme dhe në Runevë të Kaçanikut. Këto stacione kishin dy lloj funksionarësh doganorë: *procuratores vilici* dhe *tabularii*.⁴⁸ Stacionet e beneficuarëve konsularë, pjesërisht me karakter ushtarak, ishin edhe një institucion i ri që sollën romakët (fundi i shekullit II). Këto stacione në Kosovë u takonin dy legjioneve të Mezisë: *Legio VII Claudia* dhe *Legio IV Flavia* dhe gjurmët e këtyre stacioneve janë dëshmuar në Dobruzhdë të Prizrenit, në Ulpianë, në Mitrovicë dhe në Kaçanik.

Pushtimet romake sollën edhe qarkullimin e ri monetar dhe në Kosovë janë gjetur gati të gjitha monedhat e farkuara gjatë shekujve I-V, të perandorëve dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, duke përfaqësuar edhe qendrat e ndryshme të farkimit (Romës, Londrës, Lionit, Akulesë, Arlit, Konstantinopojës, Selanikut, Antiokisë, Sisakut, Mitrovicës së Sremit, Heraklesë). Vlerë të veçantë kanë monedhat e xeheroreve dardane të gjysmës së parë të shekullit II. Një lloj i tyre farkohej në minierat e rrethit të Prishtinës dhe këto mbanin mbishkrim *METALLA ULPIANA*, ndërsa lloji tjetër farkohej në minierat e Kopaonikut dhe mbanin mbishkrim *DARDANICI*. Këto të fundit kishin figurë të një hyjneshe,⁴⁹ e cila duket se paraqet Hyjneshën Dardane. Në Dobratin të Lypjanit është gjetur edhe një prej depove më të mëdha me centenionalet e Konstantinit të Madh dhe të anëtarëve

⁴⁸ Emil Čerškov (Beograd 1969), 56; CIL III, 8178, CIL III 8173.

⁴⁹ Henry Cohen, *Description Historique des Monnaies Frappées sous l'Empire Romain II* (Paris 1882), 32-33; Harold M.A. Mattingly, *Coins of the Roman Empire in the British Museum III* (London 1996), 234, 534.

të familjes së tij, si dhe medaljoni i rrallë i perandorit Prob, i bërë nga elektroni.⁵⁰

Romakët ndeshën marrëdhënie shoqërore komplekse dhe të komplikuar, ndërsa gjatë sundimit të tyre, si dhe në provincat e tjera, shoqëria përbehej nga shtresa e qytetarëve të lirë, ku bënin pjesë latinët dhe peregrinët (qytetarët e huaj për romakët), dhe skllëverit. Vendësit kishin kryesisht status peregrini dhe kjo zgjati deri në vitin 212, kur u shpall *Edikti i Karakallës*, me të cilin e gjithë popullata fitoi të drejtën qytetare romake.

Vendbanimet e shumta të periudhës romake në Kosovë dëshmojnë për një dinamikë jete, si dhe për shtimin e banorëve në të me vendosjen e administratorëve romakë dhe të ushtarëve. Qendra administrative u bënë municipiumet, si Ulpiana te Prishtina, Municipium DD te Soçanica, Vendenisi te Gllamniku, Viciano dhe Theranda. Pranë akseve të tjera rrugore u zhvilluan qendra të mëdha, si Gradina në juglindje të Pejës dhe municipiumet te Dersniku i Klinës, Çiflaku i Gjakovës dhe Gushica e Vitisë. Zhvillimi i këtyre vendbanimeve ishte më i ngjashëm me zhvillimin e qyteteve në provincën romake të Maqedonisë se sa me ato të Mezisë së Epërme, që është rezultat i traditës pararomake të lidhur me pjesët jugore të Ballkanit. Ekzistonin edhe qendrat rajonale: *oppidum*, si dhe fshatra: *vicus*. Nga monumentet epigrafike dihet se në Kosovë gjendeshin vicus Tito, Zatidis, Perdica, Cavadinus dhe Dassa.⁵¹ Një numër i vogël i vendbanimeve është identifikuar me saktësi, si Ulpiana/Iustiniana Secunda afër Graçanicës, Vendenisi te Gllamniku dhe Municipium DD te Soçanica.⁵² Në listën e shkrimtarit bizantin Prokopit të shekullit VI (Procopius, De aedificiis IV 4 3) fshihen emrat e vendbanimeve të shumta të fortifikuara (Veletinit të Janjevës, Prizrenit, Gurabardhit/Strezovcit, Llapushnikut, Vuçakut, Shpatit/Godancit, Vlashnjës, Korishës, Cermnjanit, Batushës, Zatriqit, Kastriotit/Kostercit), Kastercit, Marecit,

⁵⁰ Efrem Pegan, *Ein bronzemedaillon des Probus auf den Triumph über Góten im Jahr 278 in Pannonien* (Beograd, 1980), Numizmatičar 3, 47-56.

⁵¹ Monument epigrafik nga Viminacium (shekulli V-VI): *...vico Dassa in provincia Dardania regione Ulpiana*.

⁵² Emil Čerškov, *Municipium DD* (Priština-Beograd: 1970), Muzej Kosova & Arheološko Društvo Jugoslavije, 44, 45.

Syriganit/Suhogërrllës, Pogradjës, Binçës, Tërpezës, Gërçarit, Lumkuqit/Samadrezhës, Dubocit etj.).

Ulpiana ishte qyteti më i rëndësishëm i Kosovës antike. Si qendër administrative dhe e menaxhimit xehetar zuri një hapësirë prej mbi 100 ha, ndërsa qyteti në brendi të mureve rrethuese kishte 28 ha, ku gjendej kampi ushtarak (400 x 400 m). Ulpiana, me rang të municipiumit nga shekulli II, kishte karakteristikat e një qyteti romak: skemën e qëndrueshme urbanistike me rrugë ortogonale, ujësjellësin, kanalizimet dhe komplekset e ndërtesave me funksione të veçanta. Në shekujt III dhe IV përmendet si qytet i madhërishtëm (*urb splendissima*) dhe si qytet i mermerit, deri sa nuk e shkatërruan gotët në vitin 471 (Jordanes, *Getica* 258 sqq) dhe kur pësoi dëme të mëdha edhe nga tërmeti i vitit 518. Perandori Justinian e rindërtoi dhe e riemëroi Iustiniana Secunda, ndërsa në afërsi ndërtoi edhe qytetin Iustinopolis (Procop., *De aedificiis* IV 1 30; 19 30). Në Ulpianë vepruan dhe u vranë dy martirët e krishterimit të hershëm: Flori dhe Lauri. Në të lindi ipeshkvi Gergenci, i njohur si misionar i krishterimit përgjatë brigjeve të Detit të Kuq (shek. VI). Ulpiana përmendet edhe në vitin 1020, në Kartën e perandorit bizantin Bazilit II.

Qendër me rëndësi ishte edhe qyteti Municipium DD te Soçanica (shekujt I-IV), i cili kishte pozitë jo të zakonshme dualistike administrativo-juridike: kishte rangun e kolonisë dhe rangun e municipiumit dhe në të ishin të vendosur *procuratores metallorum Augusti* edhe *procuratores metallorum municipii*. Në të u zbulua edhe tempulli i Antoninit, të adhuruarit të perandorit Hadrian,⁵³ i dyti i tillë në Europë dhe i vetmi në Ballkan.

Gama e varrimit shtrihet nga sarkofagët luksoz prej mermeri (Ulpianë, Gllamnik) apo plumbi (Municipium DD), përmes konstruksioneve prej tullash, të mbuluara në trajtë çatie nga shekulli IV (Tupec) e deri te varrimi në tuma (Ulpianë),⁵⁴ si ripërtëritje e traditave ilire.

⁵³ Ibidem, 82-83.

⁵⁴ Tuma në Livadhin e Çerkezit: Dragoslav Srejović, *Grob ugledne tračanke iz Ulpiane* (Beograd, 1986), *Starinar* XXXVII, 179-187; Tuma e Cernicës: gërmimet e E. Shukriut me studentët e historisë të Fakultetit Filozofik, Universitetit i Prishtinës (1988).

Objektet e vlefshme artizanale me vlera artistike nga nekropolet dhe vendbanimet e periudhës romake dhe bizantine të hershme pasqyrojnë një mirëqenie ekonomike të një shtrese të popullatës, si dhe të një niveli të lakmueshëm të zhvillimit kulturor. Jetë të lulëzuar kulturore provojnë shumë objekte të zbuluara, në veçanti mozaiku polikrom i Orfeut të rrethuar me shtazë,⁵⁵ mozaikët në Nerodime me shtatë mendimtarë grekë,⁵⁶ monumenti i Hyjneshës Dardane me dy labyrinthe apo nekropolet e pasura të Ulpianës, të Municipium DD dhe të Vendenisit. Këto objekte bartin më vete gërshetimin e frymës së re që solli sundimi romak dhe të traditës autoktone të një shtetit dikur të fuqishëm dardan.

Tradita politeiste dardane lejoi që krahas respektimit të hyjnive vendës, në veçanti të Hyjneshës Dardane, hyut Andin apo të hyjve lidhur me kultin e kuajve dhe traditën kalorëse, të respektohen dhe të përvetësohen edhe hyjni të tjerë, të cilët arritën bashkë me sundimin romak. Të tillë ishin perënditë romakë Jupiteri, Minerva, Fortuna, Merkuri, Diana apo të tjerët si Mitra, Izida, Serapisi dhe Jupiteri Dolihen, Nemezisi, Orfeu, Hekata, Asklepi, Higia apo Telesfonti. Duket se traditës më të hershme i përkon respektimi i Kalorësit Thrakas dhe Kalorësit Danubian, si interpretime të hyjve vendës, dhe i hyjnisë thrakase Zbeltiurdit. Në shumë raste, pas emrave të hyjnive të huaj që duken në monumentet votive qëndrojnë hyjnitë vendës, kryesisht në interpretimin romak të tyre (*interpretatio romana*).

Labyrinthe rrethor i monumentit kushtuar Hyjneshës Dardane nga Smira paralajmëron njohuritë kosmogonike dhe kosmologjike dardane, gjë që e bën të paqëndrueshëm mendimin se ilirët, përfshirë dhe dardanët, nuk kanë zhvilluar një kosmologji uniforme mbi të cilën është përqendruar praktika e tyre religjioze.⁵⁷ Labyrinthe është krijuar mbi konceptin e trinisë dhe përmes fushës holografike shumëdimensionale sjell qasje gjeometrike dhe numerologjike,

⁵⁵ Edi Shukriu (Prishtinë, 2004b), 47.

⁵⁶ Georgie Kovaljev, *Kasnoantička palata u Nerodimlju* (Priština, 1989), Starine Kosova IX, 87-91; Idem, *Nerodimje, Kasnoantička palata* (Ljubljana, 1990), Arheološki Pregled, 168-170.

⁵⁷ John Wilkes, op. cit., 165.

duke paraqitur kështu përfytyrimin dardan të rregullit kosmik dhe ndërlihdjen midis botës materiale dhe të mbretërisë së vetëdijes më të lartë. Nga ky labyrinth po ashtu kuptohet se besimi politeist dardan, i ruajtur deri në shekullin III dhe në krye me Hyjneshën Dardane, krijoi baza për përfaqimin e një hyu monoteist, të gjithëfuqishëm dhe të padukshëm.⁵⁸ Një shkallë e këtillë e zhvillimit të religjionit të dardanët, me elemente të fuqishme autoktone, e bëri të mundshëm përfaqimin e plotë të krishterimit, si dhe krijimin e qendrave të fuqishme të krishterimit.

Monumentet mortore dhe të kultit, kryesisht me paraqitje skematike dy dimensionale, ruajtën mjaft elemente autoktone. Veçoritë e tyre arkitektonike dhe stilistike, të kombinuara me hardhinë e rrushit e gjetet e lerthit, bënë që këto që moti të njihen me emrin *monumente dardane*.⁵⁹ Elemente autoktone gjenden edhe në monumentet tredimensionale, në Bustin e Hyjneshës Dardane nga Klllokoti, në monumentet e Perëndeshës dardane nga Rumania apo në shtatoren e Hyjneshës nga Theranda. Elemente vendëse mbajnë dhe gjuha vulgare latine dhe onomastika, kryesisht ilire, si janë emrat Longarus, Bato, Monunius, Etuta, Andia, Andio/Andinus, Annus, Anna, Catulla(?), Cinna, Cito, Dasius/Dassius, Dicco, Epicadus, Epicaris, Mesius/Messa, Nanea, Plannius, Scervidaeus, Sita, Tata/Tatta, Times, Turanis, Turelius, Vanno, Varanus, Vananilla, Varadius).⁶⁰ Në kuadër të onomastikës janë dëshmuar edhe emra thrakë dhe emra prezent vetëm në territorin dardan, si Ambia, Blicites, Bubita, Cocaius, Ettela, Maema, Mescena, Mesta, Momonia, Ninis, Passades, Pitta, Romma, Sausa, Utinadus. Entiteti i krijuar dardan, subjektiviteti i Dardanisë pararomake dhe rezistenca e gjatë ndaj romakëve bënë që dardanët t'i shmangen romanizimit të plotë dhe njëkohësisht të përvetësojnë elemente të shumta të kulturës provinciale romake dhe, më pas, të asaj bizantine të hershme.

⁵⁸ Për zhvillime të ngjashme shih: Branko Gabričević, *Studije i članci o religijama i kultovima antičkog svijeta* (Split 1987), 103.

⁵⁹ Fanula Papazoglu (Beograd, 1969), 156.

⁶⁰ Duje Rendić-Miočević, *Iliri i antički svijet* (Split, 1989), 754-755; John Wilkes, op. cit, 85.

Pas ndarjes së Perandorisë Romake (395) treva e Dardanisë hyri në përbërje të Perandorisë Romake të Lindjes, të njohur si Perandori Bizantine. Shekujt vijues karakterizohen me 1) sulmet e fiseve barbare dhe 2) përhapjen e krishterimit. Sulmet e fiseve që vinin nga veriu nisën me sulmet e hunëve, të gotëve e të tjerëve dhe, më vonë, të avarëve e të sllavëve (Procop. *Historiae quae dicitur arcane* 18 20). Perandori Justinian, për t'i mbrojtur kufijtë verior të perandorisë, ndërtoi një sistem fortifikatash në disa breza, që nga vija kufitare e Danubit në veri për të pasuar me sistemin e fortifikatave që zbriste në drejtim të jugut. Në këtë periudhë Dardaninë e goditi edhe tërmeti i tmerrshëm i vitit 518 (Marcellinus Comes, *Chronicon*, Viti 518 1). Gjatë shekullit VI perandori Justinian bëri ndërtime dhe rindërtime, si edhe në territoret e tjera të perandorisë, por vendlindjen e tij, Dardaninë, e bëri edhe qendër të pushtetit shpirtëror për një pjesë të madhe të Ballkanit.

Krizat që e kapluan perandorinë dhe sulmet e fiseve "barbare" krijuan hapësirë për pranimin e plotë të krishterimit. Gjendjen e krijuar e përshkruan Hieronimi me fjalët vijuese: *Kudo zi, kudo ofshe dhe hija e madhe e vdekjes* (Eusebius Hieronymus, *Epistolae* 16). Krishterimi në Dardani/Iliri nisi të përhapej që në kohën e apostujve, krahas besimit politeist. Besimi në Hyjneshën Dardane, që gjatë shekujve sublimoi funksione të shumta dhe që personifikonte vetë diellin, krijoi parakushte për përqafimin e krishterimit, të personifikuar përmes Krishtit dhe të parë si *Sol Invictus*.⁶¹ Në gjysmën e parë të shekullit II-të ranë edhe martirët e parë të njohur të Dardanisë: Flori dhe Lauri, gurëgdhendës.⁶² Në shekullin IV krishterimi në Dardani ishte i organizuar dhe kryepeshkopata e tij ishte në Shkup. Në shekullin VI Justiniani e bëri qytetin Iustiniana Prima qendër kishtarë (vikariat) për provincat Dardania, Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Moesia Prima, Praevalitana, Macedonia Secunda dhe Panonia Secunda (Novela XI e Justinianit, viti 535). Vikariati pushoi së ekzistuari tek në vitin 733, kur iu nënshtrua plotësisht patriarkut të Konstantinopolit.⁶³ Gjurmët e shumta arkeologjike të kishave

⁶¹ Për rolin e labyrintit dhe transformimet në labyrinthe të krishtera: P.R. Doob 1990.

⁶² Gasper Gjini, *Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća* (Zagreb, 1986), 53.

⁶³ Idem, 40.

paleokristiane janë dëshmi e jetës së organizuar kishtare dhe e mishërimit të hershëm dardan me krishterimin (bazilikat nën kishën e Shën Prendës në Prizren, në Ulpianë, në Vërmicë, në Bellacërkë, në Bajicë të Pejës, kisha e Shën Florit në Lipjan, si dhe ato brenda dhe jashtë fortesave në Veletin, Brainë, Harilaç, Bajicë, Strezoc, Samadrezhë, Balloc etj.).

Studimet parahistorike dhe antike të Kosovës provojnë se në këtë territor jeta u zhvillua që nga epoka e hershme e gurit dhe se në të u formuan dardanët, njëri nga fiset më të mëdha ilire, të cilët krijuan shtetin e tyre në shekullin IV p.K., duke e bërë një fuqi kyçe të Ballkanit gjatë periudhës helenistike. Entiteti dhe identiteti etnik dardan erdhi në shprehje edhe nën pushtetin romak, ndërsa emri i dardanëve dhe i Dardanisë u ruajt edhe gjatë periudhës bizantine. Në trojet ku më parë u zhvilluan shtetet antike ilire, si ishte dhe shteti dardan, vazhdoi jetën popullata autoktone ilire, e cila u njoh në mesjetë dhe më vonë me emrin arbër dhe shqiptar.

Bibliografia dhe burimet

- Barrett, David. *Aristophanes, The Wasps* (London: Penguin classics, 1964).
- Dechelette, Joseph. *Manuel d'archeologie prehistorique, celtique et gallo-romaine*, vol.II (Paris, 1927).
- Doob, Penelope R. *The idea of the Labyrinth from Classical Antiquity through the Middle Ages* (London: Ithaca, 1982).
- Cabanes, Pierre. *Illyriens des Bardylis à Genthios IVe-IIe siècles avants J.C.* (Paris: SEDES, 1988).
- Cohen, Henry. *Description Historique des Monnaies Frappées sous l'Empire Romain II* (Paris, 1882).
- Čerškov, Emil. *Rimljani na Kosovu i Metohiji* (Beograd: Arheološko društvo Jugoslavije, 1969).
- Emil Čerškov, *Municipium DD* (Priština-Beograd: Muzej Kosova & Arheološko Društvo Jugoslavije, 1970).
- Čerškov, Emil. „Oko problema komunikacija i položaja naselja na Kosovu i Metohiji“. *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije II* (Priština: Muzej Kosova i Metohije, 1969).
- Čović, Borislav. „Pogrebni običaji preistorijskih stanovnika glasinačkog područja“ (Sarajevo: Glasnik Zemaljskog Muzeja XVIII, 1963).
- Ferri, Naser. *Monumentet ushtarake të periudhës romake në Mezi të Epërme* (Pejë: Dukagjini, 2001).

- Fidanovski, Slobodan. „Poljanica, Glavnik, Podujevo – rimska nekropola“. (Ljubljana: Arheološki pregled, 1985).
- Gabričević, Branko. „Solarni koncept duše u religiji ilira“. Studije i članci o religijama i kultovima antičkog svijeta. (Split, 1987).
- Garašanin, Milutin. „Centralnobalkanska zona“. Praistorija jugoslavenskih zemalja. (Sarajevo: Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne i Hercegovine, 1979).
- Gjini, Gasper. *Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća* (Zagreb: 1986).
- Jaskolsky, Helmuth. *The Labyrinth, Symbols of Fear, Rebirth and Liberation*. (Boston-London: Shambhala, 1997).
- Jovanović, Aleksandar. „Prilog proučavanju skulptura sa Medijane“, Niški Zbornik 9 (Niš, 1980).
- Jubani, Bep. „Të dhëna për kulturën tumulare në Shqipërinë verilindore“. Studime Ilire I. (Prishtinë: Rilindja, 1978).
- Jubani, Bep. „Tumat ilire të Kënetës“. Iliria 2 (Tiranë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë, 1983).
- Kovaljev, Georgie. 1989 Kasnoantička palata u Nerodimlju, Starine Kosova IX, Priština, 1990 Donje Nerodimje, Kasnoantička palata, Arheološki Pregled, Ljubljana.
- Kraljević, Gojko. „Antički novci nabavljeni u Janjevu za Zbirku Zemaljskog muzeja u Sarajevu“. Glasnik Muzeja Kosova XIII-XIV (Priština: Muzej Kosova, 1984).
- Mattingly, Harold M.A. *Coins of the Roman Empire in the British Museum III* (London: 1996)
- May, John M.F. *The coinage of Damastion and the lesser coinages of the Illyro-Paenonian region* (London: Oxford University Press & Humphrey Milford, 1939).
- Mehmetaj, Haxhi. „Kulina-Teneshdol“, Arheološki pregled 1988 (Ljubljana: Arheološko Društvo Jugoslavije, 1990).
- Mikulčić, Ivan. *Skopje so okolnite tvrdini* (Skopje: 1982)
- Moscy, Alfred. *Gesellschaft und Romanisation der romischen Provinz Moesia Superior* (Budapest: 1970).
- Papazoglu, Fanula. *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*. (Sarajevo: Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne i Hercegovine 1969).
- „Ilirska i Dardanijska kraljevina.“ Iliri i Albanci. (Beograd: Srpska Akademija Nauke i Umetnosti, 1988).
- Parović, Maja. „Grčka mahaira i problem grčkih mačeva“. Godišnjak Centra za balkanološka istraživanja 18 (Sarajevo: Centar za balkanološka istraživanja. 1982).
- Pegan, Efre. „Ein bronzedaillon des Probus auf den Triumph über Götten im Jahr 278 in Pannonien.“ Numizmatičar 3. (Beograd: Numizmatičarsko Društvo, 1989).
- Rendić-Miočević, Duje. *Iliri i antički svijet* (Split: Književni krug, 1989).

- Rostovtzeff, I. Michael. *The Social and Economic History of the Roman Empire* (Oxford: Clarendon Press, 1957).
- Sergejevski, Dimitri. „Iz problematike ilirske umjetnosti.“ Centar za balkanološka istraživanja 1, Sarajevo: Centar za balkanološka istraživanja, 1965).
- Stipčević, Aleksandar. *Kultni simboli kod ilira*. (Sarajevo: Akademija Znanosti i Umjetnosti Bosne i Hercegovine 1981).
- Syme, Ronald. „Legates of Moesia“. *Dacia* 12/1968 (Bucarest: 1968).
- Shukriu, Edi. *Ancient Kosova*. (Prishtina: Ministry of Education, Science and Technology & Museum of Kosova, 2004a).
- Shukriu, Edi. *Dardania paraurbane*. (Pejë: Dukagjini, 1996).
- Shukriu, Edi. „Perëndesha Dardaniane – Ikonografia e monumenteve, simbolet dhe funksionet.“ *Kosova* 24, (Prishtinë: Instituti i Historisë 2004b).
- Shukriu, Edi. „Dardanianët në veprat e Aristofanit, Menandrit e Cecil Statit“. *Dardania Sacra* 2 (Prishtinë: 2001).
- Shukriu, Edi.: „Toponimia gradinë në suazat e zhvillimit të vendbanimeve kodrinore në Kosovë“. *Buletin i Fakultetit Filozofik* XXII (Prishtinë: 1994).
- Tasić, Nikola. *The Eneolithic Cultures of Central and West Balkans*. (Belgrade: Institute for Balkan Studies, 1995).
- Tudor, Dumitru. *Oltenia romana*. (București: Academiei Republicii Socialiste Romania, 1978).
- Tudor Dumitru - Vladescu Cristian. „Dardaniani la Romula-Malva“. *Apulum* X (Alba Julia: 1972).
- Tudor Dumitru - Vladescu Cristian. „Inscripțiile Daciei Romane“ vol. II. *Oltenia și Muntenia*, eds. Gr. Florescu, C. C. Petolescu (București: 1977).
- Thrämer, Eduard. *Paulys Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft*, (Stuttgart, 1901).
- Walbank, Frank W. *Philip V of Macedon* (Cambridge University Press, 1940).
- Wilkes, John. *The Illyrians*. (Oxford: Blackwell Publishers, 1992).
- Zaninović, Marin. „Iliri i vinova loza“. *Godišnjak Centra za balkanološka ispitivanja* XIII/11 (Sarajevo: Centar za balkanološka ispitivanja, 1976).

Appianus	Illyrica
Athenaeus	Deipnosophiste
Caesar	Bellum civilae
Eusebius Hieronymus	Epistolae
Iustinus	Historiarum Philippicarum
Jordanes	Getica

Polybius	Historiae
Procopius	De aedificiis
	Historiae quae dicitur arcane
Rufus Festus	Breviarum gestarum populi romani
Titus Livius	Ab urbe condita
Varronis	De re rustica